

Udhëzues i arsimit 9-vjeçar Për familjet e nxënësve shumëgjuhësh



TAMPEREEN KAUPUNKI

Përmbajtja

Të dhëna mbi arsimin 9- vjeçar.....	2
Vlerësimi	3
Roli i mësueses dhe nxënësit	4
Mësuesit	5
Mësuesja e klasës	5
Mësuesja kujdestare	5
Mësuesja e lëndës	5
Mbështetje në mësim	6
Mësim i veçantë	6
Shërbimet sociale të shkollës	6
Psikologu i shkollës.....	6
Infermiera e shkollës	7
Nxënësit e sëmurë dhe nxënësit që sëmuren në shkollë.....	7
Vaksinat.....	7
Mësim përgatitor për arsimin 9-vjeçar.....	7
Mësimi i gjuhës finlandeze: Finlandishtja si gjuhë e dytë dhe letërsia	8
Mësim me mbështetje gjuhësore për shumëgjuhëshit (KIETU)	9
Mësimi i gjuhës amtare.....	9
Mësimi i besimit fetar	10
Rregullat e organizimit të shkollës.....	10
Pas shkollës 9-vjeçare.....	12

Mirësevjen në shkollë!

Në këtë udhëzues tregojmë, se si është sistemi arsimor në Finlandë si dhe, çfarë lloj mësimi i japim nxënësve shumëgjuhësh.



Të dhëna mbi arsimin 9- vjeçar

Në Finlandë arsimi është i detyrueshëm për 7-17 vjeçarët. Kjo do të thotë se të gjithë fëmijët janë të detyruar të ndjekin arsimin 9-vjeçar. Shkolla 9-vjeçare përgjithësisht zgjat 9 vjet. Zakonisht fëmija mëson në shkollën më të afërt.

Viti shkollor fillon në Gusht dhe mbaron në Maj apo Qershor. Pushimet e Krishtlindjeve e ndajnë vitin shkollor në semestrin e vjeshtës dhe semestrin e pranverës. Gjithashtu gjatë vitit shkollor ka: pushime vjeshte, pushime dimri si dhe pushimet e Pashkëve. Nëse familja dëshiron të ketë edhe pushime të tjera veç këtyre, ato duhet të marrin leje nga shkolla. Ditët e festave sipas besimit përkatës fetar mund ti marrësh pushim, por duhet të lajmerosh shkollën.

Arsimi 9-vjeçar në Finlandë është pa pagesë. Mësimi, aktivitetet e organizuara nga shkolla, materialet mësimore dhe materiale të tjera të nevojshme janë gjithashtu falas. Nxënësit i jepet cdo ditë ushqim pa pagesë. Nxënësit janë të siguar gjatë ditës së shkollës si dhe gjatë kohës së rrugës për në shkollë. Transporti për në shkollë është pa pagesë nëse rruga është mbi 5 (pesë) kilometra.

Ora e mësimiit zakonisht zgjat 45 minuta, por kohëzgjatja mund të ndryshojë sipas shkollës. Ndërmjet orëve të mësimiit ka pushim të ndërmjetëm. Pushimi mbahet jashtë (në oborrin e shkollës), edhe në dimër. Gjithashtu ora e fiskulturës mbahet shpesh jashtë. Gjatë pushimit ndërmjet orëve si dhe në orët e fiskulturës, nxënësi duhet të ketë veshjet e përshtashme, sipas aktivitetit apo motit.

Emri i shkolles:

Adresa e shkolles:

Emri i drejtorit dhe numuri i telefonit:

Emri i sekretares

dhe numuri i telefonit:

Çfarë mësojmë në shkollën 9-vjeçare?

Në shkollën 9-vjeçare pjesa më e madhe e lëndëve mësimore është e njëjtë dhe e detyrueshme për të gjithë nxënësit. Lëndet mësimore që duhet të mësojnë të gjithë nxënësit janë, gjuha e nënës, gjuha tjetër e vëndit, gjuhë e huaj, dituri natyre, njohuri mbi shëndetin, besimi fetar, edukatë qytetare, histori, matematikë, fizikë, kimi, biologji, gjeografi, fiskulturë, muzikë, vizatim, punëdore dhe ekonomi shtëpiake.

Përmbajtja e të gjithë lëndëve të përbashkëta është e detyrueshme për të gjithë nxënësit. Në përmbajtjen e mësimëve të detyrueshme është edhe noti. Nëse nxënësi nuk mund të marrë pjesë në mësimin e notit për arsye madhore, orën e mësimin mund ta zëvendësojë duke marrë pjesë në mësimin e notit sipas kohës së vet, nëse për këtë është rënë dakort me shkollën, dhe nga ky mësim merret dëftese nga mësuesi apo mësuesja e notit.

Gjithashtu, përveç lëndëve mësimore të përbashkëta, nxënësi zgjedh edhe lënde me zgjedhje që mbahen në klasa të tjera. Lëndët me zgjedhje janë të ndryshme në shkolla të ndryshme.

Vlerësimi

Qëllimi i vlerësimit të nxënësit është të udhëzojë, të mbështesë si dhe të përmirësojë vetvlerësimin e nxënësit. Të mësuarit e nxënësit, punën dhe sjelljen i vlerësojmë në shumë drejtime. Që në fillim, nxënësi merr vlerësime (Feedback) udhëzuese dhe mbështetëse, si dhe njohuri mbi promovimin dhe mundësitë e tij.

Vlerësimin e mësimin të nxënësit e bëjmë me fjalë ose me numura. Vlerësimi me fjalë është i mundur në raste të tjera, përveç se në vlerësimin përfundimtar në klasë të 9. Vlerësimi me numura është 4-10. Nota 4 është refuzuese (ngelëse) dhe nota 10 është më e mira e mundshme. Në klasat 5-9, në fund të semestrit të vjeshtës, nxënësi merr dëftesë për simestrin. Në fund të vitit shkollor, në pranverë, të gjithë nxënësit pajisen me dëftesën e vitit shkollor, ku shihen të gjithë notat.

Një herë në vit, mësuesja thërret prindërit dhe nxënësin në bashkëbisedim mbi vlerësimin, ku flitet për mësimin e nxënësit, gjendjen në shkollë, pika të forta dhe pika të dobëta të nxënësit. Diskutimi i përbashkët i mësueses, nxënësit dhe prindit paraprijnë besim ndërmjet njëri-tjetrit dhe shkëmbejnë informacione mbi gjendjen e nxënësit. Prindërit kanë të drejtë të kërkojnë përkthyes për këtë takim.

Roli i mësueses dhe nxënësit

Në shkollat finlandeze roli i mësuesit është rol udhëzues. Ai/Ajo motivon dhe udhëzon nxënësin për të mësuar. Secili nxënës mëson sipas mënyrës së vet, duke dhënë më të mirën. Detyra më e rëndësishme e mësuesit është të mësojë nxënësin se si ai të mësojë sipas mënyrës së vet.

Vetë nxënësi është përgjegjës për mësimin e tij. Mësimi bazohet në besueshmërimë ndërmjet mësuesit dhe nxënësit, dhe përgjegjësinë e nxënësit në të mësuar. Detyra shtëpie jepen shpesh, por jo detyrimisht çdo ditë.

Detyra e prindërve është të mbështesë fëmijën në të mësuar si dhe të bashkëpunojë me mësuesen. Mësuesi njofton prindërit për fëmijën dhe çështje të klasës kryesisht nëpërmjet sistemit për nxënësit Wilma. Nëse është e nevojshme gjatë takimeve me mësuesin thërritet përkthyes. Prindi duhet të lajmërojë mësuesin, nëse fëmija do të mungojë në shkollë. Mesazhin mund ta dërgojë nëpërmjet sistemit Wilma, ose nëse është rënë dakort me mësuesin, mund të dërgohet mesazh nga telefoni. Nuk mjafton që fëmija të njoftojë vetë mbi mungesën në shkollë.

Qëllimi është, që nxënësit të trajtohen në mënyrë individuale. Në Finlandë, të gjithë nxënësit janë të barabartë dhe vlejné njësoj. Gjithësecili ka të drejtë të ndjehet i sigurtë në ambjentet shkollore. Në Finlandë mësuesi nuk ka të drejtë të ushtrojë dhunë ndaj nxënësit. Gjithastu as prindërit nuk mund të jenë të dhunshëm ndaj fëmijës, si dhe, nxënësi nuk ka të drejtë të ushtrojë dhunë ndaj nxënësit tjetër. Në shkollë nuk lejohet të bullizosh (shqetësosh/tallësh/ofendosh...), dhe mbi të gjitha, mbi bullizimin duhet t'i tregosh mësuesit.

Veprimtari mëngjesi dhe pasdreke për shkollorët

Veprimtaritë e mëngjesit dhe pasdrekes janë në fuksion të nxënësve të klasave 1. dhe 2. veprimtaritë zhvillohen jashtë ditës së shkollës (orëve të mësimin). Veprimtaria e mëngjesit dhe pasdrekes mbështet rritjen e fëmijës, zhvillimin, dhe shpenzimin e kohës së lirë në mënyrë të sigurtë. Për fëmijët që kanë ardhur nga vënde të tjera, veprimtaritë mbështesin përmirësimin e gjuhës finlandeze dhe integrimin. Ne këtë grup dalim jashtë, luajmë, bëjmë fiskulturë dhe bëjme detyrat e shtëpisë.

Veprimtaritë e pasdrekes mbahen gjatë ditëve të shkollës në orarin 12:00-17:00. në të gjitha pikat e kësaj veprimtarie, fëmijëve u ofrohet një vakt i lehtë (zamër) rreth orës 14:00.

Veprimtaritë e mëngjesit ofrohen vetëm në një pjesë të shkollave përpara ditës së shkollës (orarit shkollor).

Veprimtaritë e mëngjesit dhe pasdrekes kanë pagesë fikse për çdo muaj. Pagesa përcaktohet në bazë të orëve që fëmija qëndron në këtë klub. Veprimtaritë e mëngjesit dhe pasdrekes për shkollorët është pa pagesë për familjet me të ardhura të ulta. Për këtë, ata duhet të bëjnë një kërkesë nëpërmjet formularit të heqjes së pagesës (maksuapautuslomake), i cili gjendet në faqen e internetit e bashkisë së qytetit.

Mësuesit

Mësuesja e klasës


Nga klasa e 1. në të 6. mësimi zhvillohet kryesisht në klasën përkatëse në drejtimin e mësueses së klasës. Mësuesja e klasës jep mësim për shumë lëndë mësimore. Disa lëndë mësimore i japin mësuese të tjera të shkollës, siç janë psh mësuese të specializuara për lëndët, si shembull mund të marrim; mësuesja e "gjuha finlandeze si gjuhë e dytë" (S2). Mësuesja e klasës bën bashkëpunimin midis shtëpisë dhe shkollës si dhe ndjek mësimin dhe mungesat e nxënësit.

Emri dhe informacion kontakti i mësueses së klasës:

Mësuesja kujdestare

Të gjitha klasat 7. - 9. kanë mësuesen e vet kujdestare, e cila ndjek mësimin dhe mungesat e nxënësve të klasës së saj. Mësuesja kujdestare është gjithashtu përgjegjëse për të ndihmuar në planifikimin dhe organizimin e nxënësit. Ajo njofton prindërit për çështjet në shkollë. Zakonisht mësuesja kujdestare u jep nxënësve vetëm për disa orë mësimi. Mësuesja kujdestare i fton prindërit një herë gjatë vitit shkollor, për të biseduar mbi çështje shkollore të fëmijës.

Emri dhe informacion kontakti i mësueses kujdestare:



Mësuesja e lëndës

Në klasat 7. -9. nxënësi ka shumë mësuese të ndyrshme, të cilat i quajmë mësuese të lëndës. Mësuesja e lëndës është e specializuar për lëndën që ajo jep, ajo e drejton nxënësin në mësimin e lëndës së saj, për shembull në matematikë. Nëse është e nevojshme, mësuesja e lëndës

ofron mbështetje në mësim dhe bashkëpunon me mësuesen për mësim special. Kontaktet me mësuesen e lëndës gjenden ne faqen e internetit të shkollës përkatëse.

Mbështetje në mësim

Nëqoftëse nxënësi përpiket shumë, por gjithsesi nuk mëson, ai ka mundësi të marrë mbështetje në mësim.

Mbështetje në mësim

Nxënësi ose prindërit mund të kërkojnë mbështetje në mësim tek mësuesja, ose mësuesja mund të sygjerojë mbështetje në të mësuar, nëse shikon se ai do të ishte i dobishëm. Mbështetja ofrohet për disa seanca dhe jo gjatë gjithë kohës. Kjo mbështetje nuk ka për qëllim arritjen e notës maksimale, por ndihmën në vështirësitë në të mësuar.

Mësim i veçantë

Mësimi i veçantë jepet në grupe të vogla për ato lëndë, në të cilat nxënësi ka vështirësi. Nevojën për këtë mbështetje e vendos mësuesja e lëndës, mësuesja e klasës, mësuesja e mësimi të veçantë ose grupi kujdestar i nxënësit në mirëkuptim me nxënësin, dhe nëse është e nevojshme me kujdestarin e fëmijes (prindi). Në Tampere gjithashtu funksionojnë klasa të veçanta. Në këto klasa mësimi i veçantë mbahet gjatë gjithë kohës.

Mbështetje për nxënësin në shkollë janë gjithashtu kujdesi për shëndetin dhe kujdesi për nxënësin. Punonjësit e kujdesit për nxënësin janë punonjësit socialë të shkollës, psikologu i shkollës dhe infermiera e shkollës.

Shërbimet sociale të shkollës

Shërbimet sociale të shkollës janë punonjësit socialë të shkollës. Nga ata merr ndihmë, nëse i riu ka probleme me mbarëvajtjen në shkollë, në mardhënie me shokët, apo nëqoftë se në jetën e tij kanë ndodhur ndryshime, të cilat mund të ndikojnë në mbarëvajtjen në shkollë. I riu mund të marrë ndihmë nga shërbime sociale të shkollës edhe për çështje që lidhen me jetën dhe zhvillimin e tij. Zgjidhen në situata të vështira e kërkojmë bashkë me të riun, kujdestarin (prindin) dhe të rritur të tjerë të shkollës

Psikologu i shkollës

Psikologu i shkollës mund të ndihmojë, kur nxënësi ka nevojë për mbështetje për të kuptuar ndjenjat dhe vështirësitë gjatë zhvillimit, si të qartësohet dhe si të veprojë ne situata të komplikuar, bashkë-komunikim në shtëpi dhe në shkollë, si dhe në vështirësitë në të mësuar

Infermiera e shkollës

Infermiera e shkollës punon në shkolla të ndryshme. Infermiera e shkollës ndjek rritjen dhe zhvillimin e fëmijës në bashkëpunim me prindin dhe doktorin e shkollës. Kujdesi i shëndetit në shkollë nuk zëvendëson qendrën shëndetësore. Infermiera e shkollës dhe doktorri i shkollës bëjnë kontrolle shëndetësore, ku ndiqet fiziku i fëmijës, rritja psikologjike dhe sociale si dhe hecuria e rritjes/zhvillimit të fëmijës. Në rast sëmundjesh duhet të kerkoni shërbim nga qendra shëndetësore përkatëse.

Për asrye sigurie të nxënësit, prindi duhet të lajmërojë tek infermiera dhe mësuesja, nëse fëmija ka sëmundje kornike dhe barna mjeksore që nxënësi merr rregullisht.



Nxënësit e sëmurë dhe nxënësit që sëmuren në shkollë

Fëmijët e sëmure nuk duhet të dërgohen në shkollë. Infermiera e shkollës nuk ka funksionin e mjekes, por tek ajo mund të shkosh gjatë orarit mësimor, nëse fëmija vritet në shkollë.

Vaksinat

Prindërit dërgojnë tek infermiera e shkollës dokumentin mbi vaksinat që fëmija ka marrë më parë. Nëse ky dokument mungon, infermiera e shkollës me lejen e prindit hap për fëmijën sistemin që përdoret në Finlandë për vaksinat.

Mësim përgatitor për arsimin 9-vjeçar

Mësim përgatitor për arsimin 9-vjeçar është në funksion të fëmijëve 7-16 vjeçar, të cilët ende nuk zotërojnë gjuhën finlandeze. Në këtë mësim nxënësve u mësohet gjuha finlandeze si dhe

bazat e lëndëve të tjera mësimore sipas moshës së fëmijës. Qëllimi i mësimit përgatitor është të arrihet niveli bazë dhe përmirësim i gjuhës, përmirësim i cili do të vazhdojë në shkollën e përgjithshme 9-vjeçare.

Në shkollat finlandeze, njohja me kulturën, gjuhën dhe njohja me funksionimin arsimor është pjesë e rëndësishme e mësimit përgatitor. Gjithashtu në mësimin përgatitor mësohen lëndë mësimore të ndryshme me përmbajtje dhe fjalor të nivelit mesatar. Besim fetar apo njohuri mbi funksionin e jetës nuk mësohen gjatë kohës së mësimit përgatitor.

Mësimi përgatitor zgjat një vit. Pas kësaj nxënësi zhvendoset në shkollën e tij më të afert. Në bazë të aftësive të nxënësit, ai vendoset në klasën e moshatarëve të vet ose në klasën ku janë nxënës një vit më të vegjël. Klasën e përshtashme për nxënësin e vendos shkolla.

Në takimin mbi fillimin e mësimit përgatitor sqarojmë historinë shkollore të nxënësit si dhe nevoja të veçanta që ai mund të ketë. Në bashkëpunim me prindin dhe nxënësin, mësuesja përgatit programin mësimor personal, në bazë të së cilit do të zhvillohet procesi mësimor gjatë kohës së mësimit përgatitor. Gjithashtu prindërit e nxënësit takohen me mësuesen të paktën dy herë gjatë mësimit përgatitor. Në rast se nevojitet mund të kërkohet përkthyes.

Emri dhe kontakte të mësueses së mësimit përgatitor:



Mësimi i gjuhës finlandeze: Finlandishtja si gjuhë e dytë dhe letërsia

Gjatë mësimit të Finlandishes si gjuhë e dytë dhe letërsia (S2) nxënësi përforcon aftësitë e tij në gjuhën finlandeze. Sasia mësimore e S2 si detyrë e veçantë është të mbështesë fëmijën në zhvillimin shumë gjuhësh. Programin mësimor S2 bashkë me mësimet e gjuhës finlandeze ke të drejtë ta kërkosh gjatë gjithë arsimit 9-vjeçar, nëse është e nvojshme. S2 ndihmon pjesërisht mësimin e gjuhës finlandeze dhe letërsisë. Vlerësimi i nxënësit S2 në gjuhën finlandeze bëhet sipas qëllimeve të vendosura në lëndët mësimore S2

Mësimi S2 mund të merret në një grup të vogël S2 ose në orën e mësimit të gjuhës finlandeze si gjuhë e nënës. Me të arritur një nivel të mirë të gjuhës finlandeze, nxënësi mund të transferohet plotësisht në orët e mësimit të gjuhës finlandeze dhe letërsisë. Nevojat që nxënësi ka për sasi të orës S1 dhe S2 e vendosin mësueset e lëndëve përkatëse në bashkëpunim midis tyre. Gjithsesi vendimin përfundimtar të zgjedhjes e bën prindi apo kujdestari i nxënësit.

Emri dhe kontaktet e mësueses S2:



Mësim me mbështetje gjuhësore për shumëgjuhëshit (KIETU)

Mësim me mbështetje gjuhësore u jepet kryesisht nxënësve të klasave 7-9 pas shkollës përgatitore, të cilët kanë shumë nevojë për mbështetje gjuhësore për të hecur përpara me mësimet. Kjo mbështetje gjuhësore mund të merret në klasat më të vogla në moshë (klasa 1-6)

Grupi i nxënësve që marrin mësimin me mbështetje gjuhësore i përkasin klasave normale dhe marrin pjesë në mësimet e klasës së tyre sa më shumë të jetë e mundur. Orari mësimor i nxënësit, me mbështetje gjuhësore bashkohet me orët mësimore të mësueses KIETU sipas nevojave që nxënësi ka. Ndihma jepet kryesisht në lëndët egzakto, në të kuptuarit në lexim si dhe mësim në terminologji dhe fjalor. Mësimi KIETU mbahet gjithashtu si mësim i njëkohshëm. Në këtë rast mësuesja KIETU është si mësuese e dytë në orën mësimore të klasës së nxënësit. Mësimet KIETU nuk është e mundur të mbahen në të gjitha shkollat.

Mësimi i gjuhës amtare

Ruajtja e gjuhës amtare apo gjuha e nënës dhe kulturës forcon identitetin e nxënësit, mbështet balancën dhe përshtatjen me bashkësinë si dhe ndihmon në vlerësimin e kulturave të tjera. Zhvillimi i gjuhës amtare ndihmon në të menduarit dhe të mësuarit e gjuhëve të tjera. Pjesëmarrja në mësimin e gjuhës amtare është e lirë. Në momentin që nxënësi regjistrohet në mësim, atëherë ai duhet ta ndjekë atë rregullisht.

Në mësimin e gjuhës amtare mund të regjistrohen nxënësit, gjuha amtare e së cilëve, apo njëra nga gjuhët e familjes nuk është Finlandisht apo Suedisht. Gjithashtu mund të regjistrohen edhe finlandezët, të cilët janë të rikthyer nga vënde të tjera, dhe gjatë qëndrimit në shtetin tjetër kanë mësuar gjuhën tjetër në nivelin e gjuhës amtare (orët për mirmbajtje të gjuhës së mësuar në shtet të huaj). Mësime bazë për të plotësuese mbahen edhe për nxënësit saame-folës dhe romanët.

Grupi mësimor formohet, nëse në orët e mësimin regjistrohen mjaftushëm nxënës. Mësimi mund të mos mbahet në shkollën përkatëse të fëmijës. Prindërit apo kujdestarët kujdesen vetë për transportin e fëmijës në orën e mësimin të gjuhës amtare. Zakonisht mësimi mbahet pas orarit shkollor.

Më shumë informacione mbi regjistrimin në mësim: [Oman äidinkielen opetus \[Tampereen kaupunki - Koulutus - Perusopetus - Opiskelu perusopetuksessa - Monikieliset oppilaat\]](#)

Mësimi i besimit fetar

Nxënësi ka të drejtë të marrë mësim mbi besimin fetar përkatës, nëse nxënësit që i përkasin të njëjtit besim janë të paktën tre, dhe prindërit e kërkojnë këtë mësim. Në vend të besimit fetar, nxënësit mund të marrin njohuri të përgjithshme mbi jetën (jo luterianët). Nëse fëmija nuk i përket asnjë besimi fetar, ai automatikisht kalon në mësimet e njohurive të përgjithshme mbi jetën.

Rregullat e organizimit të shkollës

1. Përshtatja me rregullat e shkollës

Dita shkollore përmban programin mësimor sipas orarit, pushimet ndërmjet orëve, veprimtaritë e mëngjesit dhe pasdrekës, si dhe eskursionet apo aktivitete të tjera të zhvilluara nga shkolla. Ambjente shkollore quajmë ndërtesën e shkollës, oborrin si dhe zona dhe vënde të tjera, ku jepet mësim.

2. Të drejtat dhe detyrimet e nxënësit

Të gjithë nxënësit janë në pozicion të njëjtë dhe të bartabartë, kanë të drejtat civile dhe njerëzore, si dhe kanë të drejtën të ndjehen të sigurtë në ambjentet shkollore. Të gjithë punonjësit e rritur të shkollës si dhe nxënësit kanë për detyrë të njoftojnë, nëse vërejnë bullizëm, shqetësime dhe dhunë. Lajmërimi i bëhet të rriturve (psh mësueses). Të gjithë nxënësit kanë për detyrë të marrin pjesë në mësim, të zbatojnë detyrat në çdo orë si dhe të sillen sipas rregullave.

3.1 Sjellja e mirë

Të gjithë kujdesen për të tjerët, përdorin fjalor të rregullt në të folur, zbatojnë rregullat në sjellje si dhe u japin të tjerëve qetësi në të mësuar. Tekstet e punuara nga nxënësit nuk mund të kopjohen apo të fotografohen pa leje apo pa njoftuar dhe publikuar burimin. Të gjithë duhet të kujdesen për mirmbajtjen e objekteve të shkollës dhe materialet mësimore. Prekja e gjërve të të tjerëve pa leje është e ndaluar. Në rast se shkaktohen dëmtime duhet të lajmërohet personeli i shkollës. Nxënësi që ka shkaktuar dëmin duhet ta paguajë atë sipas ligjit mbi dëmshpërblimin.

3.2 Të qëndruarit dhe lëvizja

Në pushimin ndërmjet orëve qëndrojmë në ambjentet e pushimit dhe zbatojmë udhëzimet e kujdestares së pushimit. Në rast se është e nevojshme nxënësi mund të kërkojë ndihmë nga kujdestarja e orës së pushimit. Në orën e mësimit duhet të arrish në orar dhe në pushimin ndërmjet orëve duhet të lëvizim pa vonesa. Gjatë orarit shkollor nuk mund të largohesh nga ambjentet shkollore pa lejen e mësueses. Për asrye sigurie, mjetet e transportit duhet të vendosen në vendet e krijuara posaçërisht për to gjatë orarit mësimor.

3.3 Përdorimi i kompjuterave dhe telefonave mobilë


Pajisjet mobile nuk mund të përdoren apo mbahen në dukje pa leje gjatë orës së mësimit apo orarit të ushqimit. Nxënësi kujdeset, që telefonat apo pajisjet mobile, të mos shqetësojnë programin mësimor.

3.4 Intoksikimi dhe gjëra të rrezikshme

Sipas ligjit finlandez, produkte të duhanit, lëndët toksike dhe narkotike janë të ndaluara të mbahen dhe përdoren nga fëmijët nën moshë. Armë të mprehta, zjarrvënëse, veprime me lazer, apo mjete të tjera të prodhuara me qëllim dëmtimin e të tjerëve apo materialeve të të tjerëve nuk lejohen të sillen në shkollë.

3.5 Disiplina

Mos zbatimi i rregullave mund të ketë si pasojë diskutime me mësuesen, vënie në dijeni të prindërve, përjashtim nga klasa, bisedim mbi rritjen e fëmijës, dënim pas orarit shkollor (jälki-istunto), vërejtje me shkrim, refuzim i pjesmarrjes në mësim, bërje e detyrave të shpisë pas ditës së punës, pastrim me detyrim, kontrollim i mjeteve dhe lëndëve të ndaluara dhe konfiskimin, ose edhe përjashtim nga shkolla për një kohë të caktuar.



shkollës 9-vjeçare

Pas arsimit 9-vjeçar, detyrimi i të mësuarit vazhdon, dhe nxënësi duhet të kerkojë një shkollë tjetër arsimore. Në klasat 7-9 udhëzuesja e nxënësve të shkollës u tregon nxënësve variante të ndryshme se ku ato mund të mësojnë në vazhdim. Zakonisht pas arsimit 9-vjeçar kërkohet të mësohet në shkollë të mesme të përgjithshme (gjimnaz) ose në shkollë të mesme profesionale. Periudha e aplikimit është në dimër Shkurt-Mars. Shkollën e mesme të përgjithshme ose shkollën e mesme profesionale mund ta përfundosh në periudhë 2-4 vjeçare.

Në nivelin e dytë arsimor mësimi është falas. Pas shkollës së mesme të përgjithshme ose shkollës së mesme profesionale mund të aplikohet për shkollë të lartë profesionale ose universitet. Secili prej tyre ka periudhën e tij të aplikimit

Mësimi i detyrueshëm në shkollë përfundon kur nxënësi mbush 17 vjeç. Nëse nxënësi mbush 17-vjeç në kohën kur është në arsimin 9-vjeçar, në vitin e ardhshëm shkollor ai zhvendoset në shkollën bazë për të rritur.

Emri dhe kontaktet e Këshilltares në mësim:

Si mundem të mbështes fëmijën tim në mbarvajtjen në shkollë

- E vlerësoj shkuarjen në shkollë, dhe për këtë, flas me fëmijën tim.
- Marr pjesë në takime me prindër.
- Kujdesem që fëmija im të ketë të gjitha mjetet e nevojshme për në shkollë: Çantën e shkollës, kuletën e lapsave, vizore etj, rroba të përshtatshme për orën e fiskulturës. Fëmija ka për detyrë të kujdeset që të ketë gjithmonë me vete në shkollë librat, fletoret dhe mjetet e tjera të nevojshme për në shkollë, si për shembull lapsat, gomat fshirëse, vizoret etj.

- Jam e interesuar për mbarëvajtjen e fëmijës në shkollë. Pyes për ditën e shkollës: Çfarë mësove sot? Çfarë bëre gjatë pushimit ndërmjet orëve? Çfarë hëngre? Kush është shoku/shoqja jote në shkollë?
- Kujdesem që fëmija të flejë mjaftueshëm, ha rregullisht dhe lëviz mjaftueshëm. Është mirë që përdorimi i telefonit të kontrollohet, dhe të vendosen kufinj në përdorim nëse është e nevojshme.
- Mungesat: Lajmëroj në shkollë nëse fëmija është i sëmurë. Fëmija nuk mund të vijë në shkollë nëse është i sëmurë
- Kujdesem, që fëmija të shkojë në shkollë rregullisht. Nëse fëmija ka shumë mungesa, proçesi i të mësuart vështirësohet dhe detyrat shtohen. Në shkollë kontrollohen mungesat dhe mungesat pa arsye kanë pasoja.
- Kontaktoj mësuesen, nëse kam pyetje apo diçka shqetësuese në lidhje me shkollën.
- Kujdesem që fëmija të bejë detyrat e shtëpisë. Detyrat e shtëpisë janë puna më e rëndësishme e shkollës. Mundësoj që fëmija të bejë detyrat qetësisht. Detyrat duhet të bëhen edhe në ditët që ka munguar në shkollë.

Faqe interneti për më shumë informacion:

[Tampereen kaupunki monikieliset oppilaat](#)

[Koulunkäynti ja oppimisen opas-tuki eri kielillä \(VIP-verkosto\)](#)

[Koulusanastot eri kielillä](#)

Teksti i udhëzuesit: Terhi Kuokka

Teksti u korrigjua dhe përditësua në Shkurt 2024: Johanna Heikkinen, Kristiina Jokinen dhe Miina Sivula

Fotot e udhëzuesit: Tussitaikurit Oy

